ii/c. Organizimi dhe Staf: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si

më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>5</i> | <i>6</i> |
|--------------------------------------|---|--------------|--------------------------|------------------------|--|
| Artikulli | Përshkrimi i shërbimit | Sasia | Njesia | Çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim (3 x 5) |
| 1. | Evadim mbetjesh urbane | 2728 | Ton/Vit | | |
| 2. | Larje, Dizinfektim dhe klorifikim kazanash dhe 5m2 perreth tyre | 90 VMM | Vend grumbullim mbetjesh | | |
| 3. | Fshirje, Krehje, Grryerje | 30576000 | m ² /Vit | | |
| Çmimi Neto pa TVSH (1, 2, 3,) | | | | | |
| TVSH (%) (1, 2, 3,) | | | | | |
| 4. | Pagat e punonjesve + Sig Shoqerore dhe Sig Shendetsore | 14 | Punonjes ne vit | | |

| | | |
|---|--|--|
| Çmimi total me TVSH: | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | |
| Nënshkrimi | | |
| Vula | | |
| Datë _____ | | |

Formaluari i Ofertes permban 4 zera nga te cilet:

- **Zeri 1, 2, 3, jane sherbimet qe do te kryhen, mbi te cilet aplikohet TVSH 20%**
- **Zeri 4, eshte paga e punonjesve + Sig shendetsore dhe shoqerore, mbi te cilet nuk aplikohet TVSH 20%**

Kujdes: Vlera e ofertes me TVSH nuk duhet te kaloje fondin limit prej 19 922 587.2 leke ne vit me TVSH, te akorduar nga Bashkia Durres.

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi, Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Qëllimi i Specifikimeve Teknike

Këto Specifikime teknike synojnë që të saktësojnë kërkesat e NSHK Durres, Bashkia Durres në vijim Autoritetit Kontraktues, në lidhje me qëllimi e Kontratës për Sherbim i Pastrimit te Njesise Administrative Ishem të shërbimit (sic specifikohet më poshtë), në sasinë dhe cilësinë dhe shpërndarjen e këtij shërbimi të përcaktuara në Termat e Referencës dhe në hartat bashkëlidhur .

Për realizimin e preventivit , per kalimin me siper marrje te pastrimit dhe evadimit te mbetjeve ne Njesite Administrative te Ishmit, grupi i punes u mbeshitet ne keto te dhena :

1-Popullsia e korrektuar, midis te dhenave sipas rregjistrimit te gjendjes civile dhe shtesave te popullsise gjate sezonit te veres eshte:

a- Ishëm: - **12 100 banore.**

2- Volumet ditore dhe vjetore te pastrimit jane te bazuara ne normat qe perdore sot Ndermarrja e Sherbimeve Komunale Durrës,te cilat jane pasqyruar ne nje tablele ngjitur preventivave.

3- Numri i vmm-ve do te jete sipas shtrirjes demografike te popullsise si me poshte :

a- Ishëm : Gjithsej **90 vmm** , nga te cilat 8 pika do te jene vmm te hapura.

4- Numri i kazaneve qe duhen eshte ne varesi te sasise se mbetjeve dhe frekuences se evadimit.

Numri i kazaneve 1100 litra do te jete :

a- Ishëm : Gjithsej **150 kazane** 1100 litra.(1 kazane per 85 banore)

5- Frekuenca e evadimit te mbetjeve te ndryshme, do te jete **1/here ne 24 ore** , ne disa lagje te fshatrave te cilat kane largesi mbi 3 km dhe gjenerimi i mbetjeve eshte me i ulet ,evadimi i mbetjeve urbane do te behet 1 here ne 3 dite.

6- Sasite e planifikuara te mbetjeve qe do te evadohen per cdo dite, do te jene simbas mesatares ditore te mbetjeve te gjeneruara si Bashki gjate vitit 2024, qe ka qene mesatarisht 0.56 kg/fryme ne dite, konkretisht jane:

a- Ishem: **2 728 ton / vite ose 7.5 ton /dite.**

7- Depozitimi i mbetjeve urbane do te behet ne Landfillin perkates ne te cilin Bashkia Durres ka lidhur nje kontrate.

8- Numri i mjeteve te transportit qe duhen per kryerjen e shërbimit ne njesine Ishem eshte :

a - Mjet transporti Autoagregat mbi 16 m³ **cope 1** (nje)

b- Mjet transporti kamion te hapur mbi 8 m³ cope 1 (nje)

c- Mjet autobot per larje kazanesh mbi 6 m³ cope 1 (nje)

d- Mjet fadrom per skarifikime dhe ngarkesa inertesh. cop 1 (nje)

9- Fuqia puntore prej **14 puntoresh** ,do te punoje ne **6 dite te javes me 6.7 ore ne dite**, ose 40 ore ne jave , 176 ore ne muaj,e shperndare sipas proceseve te punes duke u shtrire ne gjithe siperfaqet urbane ku shtrihen fshatrat e kesaj njesie.

10- Firma fituese, e siper marrjes se ketij shërbimi ne fillim te punes te hartoje :

a- Planet e punes per cdo muaj .

b- Grafikon e realizimit te shërbimit, me synim rritjen e performances .

c- Kronometrimin e harxhimit te naftes per cdo mjet si pas itinerarit te punes.

Grupi i punës për hartimin e preventivave, për kalimin me siper marrje te shërbimit te pastrimit, dhe evadimit te mbetjeve ,ne Njesine Administrative Ishem , eshte mbeshitetur ne kete **bazueshmëri ligjore** :

-
- 1- Urdheri Nr.182 prot. date 26 .05. 2025 te N.SH.K .Durrës për hartimin e preventivit të Shërbimit të Pastrimit të Njesisë administrative Ishëm .
 - 2- Shkresa me Nr.546 prot. date 26.05.2025 dërguar nga NSHK Durrës, njesisë administrative Ishëm, për dërgim të dhenash,për kalimin me sipërmarrje private të shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së zonave urbane.
 - 3- Shkresa me Nr.325/1 prot. date 09 .06 .2025 e Njesisë Administrative Ishëm ,mbi të dhënat për numrin e banorëve,numrin e v.m.m-ve dhe vendndodhjen e tyre,numrin e turistëve frekuentues si dhe numrin e bizneseve të Ishmit.
 - 4- Shkresa me Nr. 12677 prot. date 30.10.2024 të Bashkisë Durrës për lidhjen mbi nivelin e ri të pagave sipas V.K.B. Durrës me Nr. 95 date 28.10.2024.
 - 5- Evidencën përmbledhëse të sasive së depozitimit të mbetjeve në Landfillin e Sharres për vitin 2024 si Bashki.(Mesatarja për frymë e mbetjeve në ditë .)
 - 6- V.K.M. Nr.319, date 31.05.2018 mbi mënyrën e llogaritjes së kostos për pastrimin dhe evadimin e mbetjeve urbane.
 - 7- Ligji nr.136 i vitit 2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7961 date 12.07.1995 (Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë).
 - 8- V.K.M Nr.581 Date 17.07.2013 e ndryshuar, me V.K.M. Nr.1114 date 30.07.2008 (Sig. Shoqërore + sig.shëndetsore)
 - 9- Procesverbalet e hartuar nga grupi i punës, për kronometrimin e konsumit të karburantit të mjeteve, që janë në proces pune për evadim mbetjesh urbane.
 - 10- Shkresa me Nr. 559 prot.date 27.05.2025 për informacion mbi cmimet e mallrave në magazinën e NSHK. Durrës, për vitin 2025.

2. Skicimet, parametrat teknik etj:

2.1 Zona e Shërbimit

1. Shërbimi mbulon territorin e Njesisë Administrative Ishëm (harta bashkëlidhur). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të njesisë është vlerësuar rreth 12.100 banorë rezidentë.
2. Gjithsej do të bëhet pastrimi i 90 pika VMM (vend i mbajtjes së mbeturinave) të mbetjeve urbane të shpërndara në të gjithë territorin e Njesisë Administrative Ishëm , sipas hartave treguese me emrat e fshatrave dhe zonave të poshteshnuara. (harta bashkëlidhur)

SHKAFANE

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




SHETAJ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE



SHENPJETER

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




RROTULL

PLAN VENDOSJA SH.1:10000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




LALEZ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




GJYRICAJ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




DRAC

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE



BIZE

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE



3. Numri i kazaneve per cdo VMM eshte ne varesi te sasise se mbetjeve dhe frekuences se evadimit, ku ne total duhen rreth 150 kazane 1100 litra, te shperndara ne 90 pikat e VMM-ve.

-
- a) Kontenieret duhet te jene me 4 rrota dhe kapak të shështë ose më kapak të rrumbullakosur. Në të dy rastet kapaku duhet të jetë lehtësisht i lëvizshëm për të mundësuar hedhjen e mbeturinave nga konsumatorët si dhe hapjen e tyre për shkarkimin në kamion. Nuk do të pranohen dhe nuk do të lejohet të përdoren kontenierë pa kapak dhe pa rrota. Kontenieri do të ketë dorëza anësore në të dy anët për të mundësuar lëvizjen drejt dhe për nga kamioni në Vend Mbajtja e Mbetjeve (VMM), si dhe boshtin të dy krahët për kapjen dhe ngritjen nëpërmjet mekanizmit të ngritjes për shkarkimin e mbetjeve në kamion.
- b) Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegie, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik dhe estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë ose zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ose mos zëvendësimit të tyre kur janë të riparueshëm, ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete sipas Nenit perkates "Penalitete dhe Ndalesa" në kushtet e pergjithshme te kontrates.
- c) Kontenierët do të pajisen nga Operatori në të katër cepat me flete vetengjitesë (adezive) fosforeshente, me vija të bardha dhe të kuqe për tu bërë të dallueshëm gjatë natës nga mjetet dhe njerëzit që qarkullojnë në rrugët ku janë vendosur në pikat e grumbullimit.
- d) Të gjitha Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të vendosë dukshëm numrat e VMM-ve mbi njërin nga kontenieret apo ambjentetë tjera rreth pikës sipas "Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre"
- e) Disinfektimi dhe klorifikimi (sipas termave të referencës) i kazanëve dhe i hapësirës 5m² përreth tyre do të kryhet çdo ditë, pas evadimit të mbetjeve nga kazanet duke përdorur autobotin e ujit. Me elementin e dezinfektimit kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane etj.

1. Raportet dhe Statistikat

Operatori duhet të mbajë statistika të përditshme mbi pikat kryesore të mëposhtme dhe ti raportoje supervisorit çdo muaj, në format zyrtar letër dhe në formë dixhitale:

- numri i kontenierëve të ngarkuar në çdo rrugë
- orët reale të mbledhjes: ora e nisjes së kamionëve, koha e shkarkimit në landfill, koha e kthimit në garazh/parkim
- sasinë për çdo grumbullim të mbetjeve (ton /grumbullim) që shkarkohen në landfill.
- km rrugë që përshkohen çdo ditë nga çdo kamion për grumbullimin e mbetjeve
- konsumi i naftës dhe i vajit për çdo kamion, operacionet e mirëmbajtjes dhe data

-
- f) numri dhe itinerari i rrugëve që ndjekin kamionët
 - g) lista e të punësuarve dhe orëve të punës
 - h) inventari mujor i kontenierëve, rrugë për rrugë, me numër identifikimi dhe gjendjen fizike
 - i) zhvendosjen, mirëmbajtjen ose zhdukjen e kontenierëve, larjen e tyre: lista e kontenierëve (rrugë, numri i identifikimit), riparime specifike dhe data
 - j) Informacion mbi kërkesën e supervisorit për mangësinë në cilësi ose sasinë e shërbimit;

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Në hartimin e preventivave për kalimin me sipërmarrje të pastrimit, mirembajtjes dhe evadimit të mbetjeve urbane, në njesinë administrative të Sukthit, janë parashikuar shërbimet dhe grafikët perkates, sipas proceseve të punës, si më poshtë vijon :

1- Pastrimi në teresi përfshin në vetvete disa procese siç janë :

Krehja, Gerryerja, Fshirja, dhe mirembajtja e gjithë sipërfaqes urbane të njesisë të percaktuara sipas termave të referencës, specifikimeve teknike dhe volumeve të percaktuara.

-Keto shërbime do të behen në 6 ditë të javës, me 6.7 orë në ditë, nga e Hënës në të Shtunë, duke filluar punë në orën – 07.00 deri në orën 13 e 40 minuta.

- Proceset e cituar më sipër, do të kryhen në të gjitha lagjet e fshatrave si më poshtë vijon :

Likmetaj, Drac, Shetaj, Kertushaj, Kapedane, Gjuricaj, Shkafane, Rrotull, Bize dhe Lalez.

-Të gjitha proceset e mesiperme do të kryhen në mënyrë të alternuar një herë në 2 ditë.

Volumet e punës sipas proceseve janë pasqyruar në tabelën përmbledhëse të proceseve.

2 -Mbas pastrimit, procesi i **evadimit të mbetjeve urbane**, zë vendin kryesor dhe do të kryhet me frekuencën 1 herë në 24 orë, ose 1 herë në 3 ditë për mbetjet e gjelberta dhe inertet sipas një grafiku të vecantë, të hartuar nga sipërmarrësi, në varesi të sasive të mbetjeve që gjenerohen çdo ditë .

- Në një grafik normal parashikohet të behen 2 rrugë në ditë, ku gjatë verës grafiku i evadimit do të fillojë rreth orës 05. 00 dhe do të vazhdojë deri në përfundim, kurse gjatë muajve të tjera të vitit grafiku mundet të fillojë rreth orës 08. 00 të mëngjesit dhe 12 00 të drekës.

3 –Nëder proceset e preventivuar janë dhe **Dezinfektimi ,Klorifikimi dhe larja e kazaneve.**

Proceset këto që do të kryhen sipas një grafiku të vecantë për secilin proces:

-Dezinfektimi i të gjitha pikave të vendosjes së kazaneve (vmm-ve) do të kryhet për çdo ditë mbas boshatisjes së kazaneve nga mbetjet, me gelqerë pluhur të perzier me klor pluhur në nivelin 5 %, kjo do të zbatohet edhe për mjetet në përditshmeri.

- Gjatë verës në pika të vecanta kazerat dhe mjetet do të dezinfektohen dhe me klor të lëshuem 5 % ,1 herë në javë sidomos pikat që ndodhen të plazhi anës rrugëve.

- Larja e kazaneve do të behet për të gjitha pikat 1 herë në 6 ditë ,ose 5 herë në muaj

Kurse në zonën e plazhit do të lahen 1 herë në 3 ditë në 5 muaj të vitit.

Të dhëna të tjera me të detajuara, rreth shërbimit në fjalë dhe grafikeve të realizimit, janë në mbështetje të specifikimeve teknike dhe tabelës përmbledhëse të volumeve të punimeve, të pasqyruara në preventiv të cilat do i bashkëngjiten preventivit .

GRAFIKU MUJOR I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT DHE EVADIMIT TË MBETJEVE ME SIPËRMARRJE ,NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, PËR NJË PERIUDHË 1 VJEÇARE

| Emertimi i sherbimit | | | | |
|----------------------|--------|--------------------------|-------------|----------------|
| Data | Evadim | Fshirje,krehrje,grryerje | Dezinfektim | Larje kazanesh |
| 1 | x | x | x | |
| 2 | x | x | x | |
| 3 | x | x | x | |
| 4 | x | x | x | |
| 5 | x | x | x | |
| 6 | x | x | x | x |
| 7 | x | x | x | |
| 8 | x | x | x | |
| 9 | x | x | x | |
| 10 | x | x | x | |
| 11 | x | x | x | |
| 12 | x | x | x | |
| 13 | x | x | x | x |
| 14 | x | x | x | |
| 15 | x | x | x | |
| 16 | x | x | x | |
| 17 | x | x | x | |
| 18 | x | x | x | |
| 19 | x | x | x | x |
| 20 | x | x | x | |
| 21 | x | x | x | |
| 22 | x | x | x | |
| 23 | x | x | x | |
| 24 | x | x | x | |
| 25 | x | x | x | x |
| 26 | x | x | x | |
| 27 | x | x | x | |
| 28 | x | x | x | |
| 29 | x | x | x | |
| 30 | x | x | x | |
| 31 | x | x | x | |

SHËNIM :

1. Evadimi i mbetjeve urbane do te behet me frekuencen 1 here ne 24 ore me 2 rruge ne dite ku rruga e dyte do te jete me alternative ne varesi te volumit te mbetjeve (te gjelberta ,inerte) n1 here ne 3 dite..
-Rruga e pare fillon ne oren 08⁰⁰ ne fshatin Shetaj ,vazhdon ne te gjitha fshatrat sipas itinerarit dhe nevojës per evadim mbetjesh.
-Rruga e dyte fillon ne oren 12⁰⁰ duke kontrolluar te gjitha pikat ku mundet te jene depozituar te gjelberta dhe inerte..
2. Cdo dite VMM te dizinfektohen me gelqere te pashuar + klor 5 % , nga punonjesit e transportit.
3. Ne periudha me temperatura te larta, kryesisht gjate veres te gjitha pikat e vmm-ve dhe kazanet, te dezinfektohen dhe me klor te lengshem ne dozen 5 % , pjese e dezinfektimit do te jene dhe mjetet e transportit.
4. Kazanet ne te gjitha pikat e vmm-ve do te lahen 1 here ne 6 dite ,ose 5 here ne muaj,kurse gjate sezonit te veres ne zonen e plazhit ne Gjirin e Lalezit ,kazanet do te lahen 1 here ne 3 dite ne 5 muaj te vitit(Maj – Shtator).
5. Puntoret e mirmbajtjes qe do te bejne krehjen e zonave urbane dhe grumbullimin e mbetjeve neper pika si dhe fshirjen e qendres se fshatrave kryesor.Cdo fshat do te kete puntorin e vete per mirmbajtje, ku do te punojne ne menyre te alternuar.

TE DHENAT PER ORET DHE DITET E PUNES SE FUQISE PUNETORE

| NR. | Man. | Proceset e punes | Numri fuqise puntore | Numri diteve punes | Ore pune dite | Ore pune gjithsej | Leke per ore pune | Shuma Leke gjithsej |
|-----|-------|-----------------------------------|----------------------|--------------------|---------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| 1 | Anal. | Puntor grumb mbetetjesh + krefes, | 5 | 312 | 6.7 | 10 452.0 | | |
| 2 | ^^ | Puntor fshesar | 1 | 312 | 6.7 | 2 090.4 | | |
| 3 | ^^ | Shofer transp.+boti+fadrom | 2 | 312 | 6.7 | 4 180.8 | | |
| 4 | ^^ | Puntor transporti | 5 | 312 | 6.7 | 10 452.0 | | |
| 5 | Anal. | Drejtues teknik +Adminst. | 1 | 264 | 8 | 2 112.0 | | |
| -- | ^^ | Shuma fuqi puntore | 14 | -- | -- | --- | -- | |
| | | SHUMA 1 | ---- | --- | --- | ----- | --- | |
| | | Sigurimet shoq. 16.7 % | | | | | | |
| | | SHUMA 2 | | | | | | |
| | | Fitimi | | | | | | |
| | | SHUMA TOTALE | | | | | | |

TË DHËNA PËR VOLUMET E PASTRIMIT, DHE EVADIMIT, PËR HARTIMIN E PREVENTIVAVE PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM , PËR NJE VIT KALENDARIK

| Njesia Admin. | Siperf. teritor. Km ² | Sipef. Urbane M ² | Popull. e korre. banore | Trotuare +sheshe 000/m2 | Kuartalla 000/m2 | Shuma Gjithsej 000/m2 | Trajtohet Ne dite 000/m2 | Trajtohet Ne vit 000/m2 | Num.fuqi puntore gjithsej | Shenime. |
|---------------|----------------------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------|------------------|-----------------------|--------------------------|-------------------------|---------------------------|-------------------------------------|
| ISHËM | 91 | 150000 (0.15) km ² | 12 100 | 24 | 150 | 174 | 98 | 30 576 | 14 (6) | Afersisht 1 here ne 2 dite pastrimi |

TË DHËNA TË DETAJUARA SIPAS PROCESIVE, PËR NJËSIN ISHËM .

| Nr | Proceset | Njesia Ishëm | | | | Shenime . |
|--|----------------------------------|-------------------|--|---------------------------------|------------------------------|--|
| | | Nr.punt. | Norma 000/m ² | Vol.dit. 000/m ² | Vol.vjet. 000/m ² | |
| 1 | Punt.krehes ,grumbullues | 4 | 20 | 80 | 24 960 | Normat jane mbeshtetur ne normat qe zbaton NSHK. Durres. Punohet 6 dite ne jave me 6.7 ore/dite. Ose 40 ore ne jave (176 ore/muaj) 312 dit/vit |
| 2 | Punt. gerryes | 1 | 4 | 4 | 1 248 | |
| 3 | Punt. fshesar | 1 | 14 | 14 | 4 368 | |
| 4 | Punt. transporti | 5 | A (3) .K (2) | ----- | 432 rruge | |
| 5 | Shof. trans+ autoboti +fadrom | 2 | 2 | 2 rruge | 562 rruge/ore | |
| 6 | Drejt. teknik. | 1 | 6.7 ore/dite | | 312 dite | |
| | Shuma fuqi puntore: | 14 | | | | |
| --- | Vol. Mbetjeve ne ton. | Agrg. 1 Kam. 1 | 1.rrug/dit 1.rrug/dit | 7.5 ton/dite A(6.8t)+K(0.7t) | 2 728 Ton / vit | Mbeshtetur ne mesataren Kg/fryme/dite ne vitin e fundit 2024 si Bashki 0.56 kg/frym/dite.per 12 100 banore |
| ---- | Numri kazaneve | 1100 lit | 150 kazane 1100 litra | | | Mesatarisht 1 kazane per 85 banore |
| ---- | Frekuenca e evadimit te mbetjeve | 1/here /24 ore | Ne disa fshatra dhe lagje sipas mbetjeve te gjeneruara ,evadimi do te behet 1 here ne 3 dite | | | Mqs.ka shtrirje gjeografike midis fshatrave dhe lagjeve , vendosem te shtojme numrinin e kazaneve ne 1 kazanene 85 banre |
| SHËNIM : Normativat e konsumit te karburantit (nafte) per 1 rruge, jane ato qe ka perdorur ndermarria jone ne kete njesi, si dhe sipas procesverbalit te kronometrimit te mjeteve qe do te perdoren per transport ne procesin e grumbullimit dhe transportit per ne landfill. | | | | | | |

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

1. Kuptimi i termave

Termet e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, në Termat e Referencës (shtojca 12), si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe VKM 608, datë 17.09.2015, “Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre”, si dhe në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Pastrimi dhe evadimi i mbetjeve urbane në Njesinë Administrative Ishem duke përfshirë të gjitha zonat e njesisë të përcaktuara në hartën treguese bashkëngjitur.

Detyrat:

Në hartimin e preventivave për kalimin me sipërmarrje të pastrimit dhe mirembajtjes, në njesinë administrative të Ishmit, janë parashikuar proceset e punës si më poshtë vijon :

- 1- Pastrimi në teresi përfshin në vetvete disa procese siç janë : krehja, gerryerja, fshirja, mirembajtja e sipërfaqeve të banuara dhe në fund evadimi i mbetjeve urbane .
Keto procese, kryen në të gjitha zonat e banuara të shtrira në **10 fshatrat me 12 100 banorë**, e përfshirë dhe vijat bregdetare të Gjirit të Lalezit, me evadimin e mbetjeve për plazhin publik.
Proceset e cituar më sipër, do të kryen në të gjitha lagjet e fshatrave si më poshtë vijon :
 - **Likmetaj, Draç, Shetaj, Kertushaj, Kapedane, Gjuricaj, Shkafane, Rrotull, Bize, Lalez dhe gjithë vijat bregdetare të Gjirit të Lalezit deri në Kepin e Rodonit.**
 - **Fshirja** konsiston në fshirjen e qendres së fshatrave kryesor, sidomos fshatrat që kanë anës rrugëve kryesore dhe trotuare, duke përfshirë rruget, trotuaret, vmm, kuartallat ose hapsirat midis rrugicave të lagjeve..
 - **Krehja**, përfshin grumbullimin e çdo lloji mbetjeje, në të gjithë territorin e njesisë por sidomos në zonat urbane duke përfshirë rruget, kuartallat dhe vijat bregdetare.
 - **Gerryerja**, presupozon gerryerjen e kunetave të rrugëve, dhe vendeve të tjera ku krijohen depozitime dherash.
 - Të gjitha proceset e mesiperme nuk kryen për çdo ditë, mbasi nuk mundet të mbulohet gjithë sipërfaqja me fuqi puntore, por keto mirembahen në mënyrë të alteruar njëherë në 2- 3 ditë.
